



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 9, datë 7.2.2018

PËR

MIRATIMIN E POLITIKËS “PËR ZGJERIMIN E PËRDORIMIT TË MONEDHËS KOMBËTARE NË VEPRIMTARINË E BANKAVE DHE TË INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKARE QË RREGULLOHEN E MBIKËQYREN NGA BANKA E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pikave 2, 3, 4, shkronjat “c” e “dh”, dhe 5, të nenit 43, shkronja “g” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Stabilitetit Financiar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë ““Politikën “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në veprimtarinë e bankave dhe të institucioneve financiare jobankare që rregullohen e mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë””, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe strukturat e tjera të Bankës së Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve përkatësisht me publikimin e këtij dokumenti në faqen e internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

Elvis ÇIBUKU

Gent SEJKO

I. Përcaktime

Në këtë dokument, sa herë që përdoren, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) ‘MFE’ – është Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- b) ‘AMF’ – është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- c) ‘ASD’ - është Agjencia e Sigurimit të Depozitave;
- ç) ‘autoritetet’ – janë MFE, AMF, ASD dhe çdo institucion tjetër i shtetit shqiptar me të cilët Banka e Shqipërisë bashkëpunon për realizimin e kësaj politike;
- d) ‘subjektet’ – janë institucionet financiare që rregullohen e mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë;
- dh) ‘palë e interesuar’ – janë autoritetet, subjektet dhe çdo person tjetër juridik që mund të ndikohet nga veprimet e ndërmarra në kuadër të kësaj politike;
- e) ‘ligji organik’ – është ligji nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ë) ‘ligji për bankat’ – është ligji nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- f) ‘ligji i shkk-ve’ – është ligji nr.52/2016, datë 19.05.2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit”;
- g) ‘ligji i sistemit të pagesave’ – është ligji nr.133/2013, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave”, i ndryshuar;
- gj) ‘ligji për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka’ – është ligji nr. 133/2016, datë 23.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- h) ‘ligji për AMF’ – është ligji nr.9762, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar;
- i) ‘memorandumi i mirëkuptimit’ – është Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar në datën 10.03.2014 nga MFE, Banka e Shqipërisë, AMF dhe ASD “Për bashkëpunimin në drejtim të parandalimit dhe të administrimit të situatave të jashtëzakonshme në veprimtarinë e sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë”, i publikuar¹;
- j) ‘GKSF’ – është Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar që funksionon sipas nenit 30 të ligjit për AMF-në dhe Memorandumit të Mirëkuptimit;
- k) ‘ligji për sigurimin e depozitave’ – është ligji nr.53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar;
- l) ‘strategjia makroprudenciale’ – është Strategjia e Politikës Makroprudenciale, e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.38, datë 02.08.2017, e publikuar²;
- ll) ‘memorandumi i bashkëpunimit’ – është memorandumi i nënshkruar në datën 18.04.2017 nga MFE, Banka e Shqipërisë dhe AMF “Për fuqizimin e përdorimit

¹ Publikuar në adresën e internetit:

https://www.bankofalbania.org/web/pub/mou_dt_10_03_2014_6521_1.pdf

² Publikuar në adresën e internetit: https://www.bankofalbania.org/web/Stabiliteti_Financiar_3448_1.php

- të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare”, i publikuar³;
- m) *‘politikë’* – është ky dokument, aty ku nuk përcaktohet ndryshe;
 - n) *‘zgjerimi i përdorimit të monedhës kombëtare’* – është rritja e peshës që zë monedha kombëtare në treguesit financiarë të subjekteve.

II. Të përgjithshme

Banka e Shqipërisë, në kuadër të kontributit që jep:

- a) si autoritet monetar, sipas ligjit organik;
- b) si autoritet mbikëqyrës dhe rregullativ i veprimtarisë së sektorit bankar dhe i veprimtarisë së disa institucioneve financiare jobankare, sipas ligjit organik, ligjit për bankat dhe ligjit të shkk-ve;
- c) si autoritet mbikëqyrës dhe rregullativ i sistemeve të pagesave, sipas ligjit organik dhe ligjit për sistemin e pagesave;
- d) si autoritet i ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka dhe në forcimin e kuadrit të administrimit të krizave në sistemin financiar, sipas ligjit për bankat, ligjit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, ligjit për sigurimin e depozitave;
- e) në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe administrimin e rrezikut sistematik, sipas ligjit organik, ligjit për bankat, strategjisë makroprudenciale dhe Memorandumit të Mirëkuptimit;

duke njohur përparësitë që ofron zgjerimi i përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar në drejtim të:

- i) përmirësimit të efektivitetit të politikës monetare dhe të politikave mikro- e makro-prudenciale;
- ii) uljes së rreziqeve për stabilitetin financiar,
- iii) përfitimeve të tjera ekonomike dhe financiare, në drejtim të qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike dhe përmirësimit të rezistencës së subjekteve ekonomike ndaj periudhave të stresit;

dhe duke vlerësuar që:

- nivelet e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar janë pasqyrë e shkallës së përdorimit të saj në të gjithë ekonominë;
- procesi i zgjerimit të përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar bëhet më efektiv nëse mbështetet në bashkëpunimin me palët e interesuara;
- zgjerimi i përdorimit të monedhës kombëtare është një proces që kërkon kohë, angazhim të vazhdueshëm dhe objektiva realistë;

³ Publikuar në adresën e internetit:

https://www.bankofalbania.org/web/pub/memorandumi_gksf_9384_1.pdf

shpreh parimisht mbështetjen dhe angazhimin e saj në këtë proces, nëpërmjet miratimit të kësaj politike.

III. Faktorët përcaktues

Procesi i zgjerimit të përdorimit të monedhës kombëtare tek subjektet, pra edhe efektiviteti i kësaj politike, është i përcaktuar nga aftësia e autoriteteve për të siguruar:

- a) qëndrueshmërinë e kuadrit të përgjithshëm makroekonomik dhe të stabilitetit financiar, si kusht themelor për të mbrojtur besimin e publikut në monedhën kombëtare;
- b) ruajtjen e regjimit të shënjestrimit të inflacionit dhe të regjimit të kursit të lirë të këmbimit, si faktorë të rëndësishëm për të krijuar stimuj të drejtë tek publiku, që forcojnë ndërgjegjësimin e tij ndaj rreziqeve financiare;
- c) zhvillimin e tregut financiar, në drejtim të zgjerimit të llojeve të instrumenteve financiare në monedhë kombëtare dhe të përmirësimit të karakteristikave të tregtimit të tyre;
- d) bashkëpunimin dhe harmonizimin e veprimeve, që gradualisht por në mënyrë të vazhdueshme, të rritet përdorimi i monedhës kombëtare në të gjithë sistemin financiar dhe në ekonominë reale.

IV. Qëllimi i dokumentit të politikës

Ky dokument ka si qëllim të përkufizojë në mënyrë të përmbledhur mënyrat me të cilat Banka e Shqipërisë do të kontribuojë në zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare dhe do të vlerësojë efektivitetin e këtij kontributi.

V. Objektivi i politikës

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet zbatimit të kësaj politike synon që, përmes qëndrimeve dhe veprimeve të saj, të kontribuojë në krijimin e kushteve që nxisin zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare (dhe uljen e peshës së përdorimit të valutave) në veprimtarinë e subjekteve.

VI. Fusha e zbatimit të politikës

1. Kjo politikë do të zbatohet mbi subjektet, duke përfshirë bankat dhe institucionet financiare jobankare.
2. Në kuadër të zbatimit me efektivitet të kësaj politike, Banka e Shqipërisë do të bashkëpunojë me subjektet dhe palët e interesuara.

VII. Përparësia në zbatimin e politikës

1. Në zbatimin e politikës, Banka e Shqipërisë do të përdorë parimin e përparësisë, i cili mundëson arritjen e objektivit të politikës në mënyrë më eficiente.
2. Në zbatimin e politikës, Banka e Shqipërisë do t'i japë përparësi:
 - a) sektorit bankar, për shkak të rolit që luan në transmetimin e politikës monetare dhe rëndësisë që ka për stabilitetin financiar;
 - b) drejtimeve të caktuara të veprimtarisë bankare, ku bankat dhe klientët e tyre përballen me një rrezik më të lartë nga ekspozimet financiare që çojnë në mospërputhje sipas monedhave.
3. Banka e Shqipërisë do të synojë të monitorojë edhe zhvillimet e tjera në tregjet financiare dhe në ekonominë reale, me qëllim që:
 - a) të vlerësojë ndikimin e mundshëm të tyre në objektivin e kësaj politike;
 - b) të identifikojë nevojën dhe mënyrën e reagimit;
 - c) të komunikojë me autoritetet për qëndrimin e mundshëm në rast nevoje.

VIII. Instrumentet e zbatimit të politikës

1. Për zbatimin e kësaj politike, Banka e Shqipërisë do të përdorë:
 - a) komunikimin me subjektet dhe palët e interesuara, operacionet monetare, masat mbikëqyrëse, propozimet për ndryshime ligjore dhe përmirësimet e tjera rregullative, si edhe të gjitha instrumentet e tjera që i mundëson kuadri ligjor e rregullativ në drejtim të zbatimit të politikës monetare, të rregullimit dhe të mbikëqyrjes së bankave dhe të institucioneve financiare jobankare, të zhvillimit dhe të mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, si edhe të ushtrimit të politikës makroprudenciale;
 - b) bashkëpunimin me autoritetet, veçanërisht për të përmbushur angazhimet e marra në strategjinë që përcakton Memorandumi i Bashkëpunimit;
 - c) komunikimin dhe edukimin publik, për të theksuar rëndësinë e zgjerimit të përdorimit të monedhës kombëtare në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.
2. Për instrumentet që mund të përdorë në kuadër të kësaj politike, Banka e Shqipërisë do të veprojë mbi bazën e një analize që krahason kostot dhe përfitimet, mbështetur në një këndvështrim afatgjatë në përputhje me objektivin e kësaj politike, dhe në harmoni me objektivat ligjorë të veprimtarisë së institucionit.
3. Përdorimi i çdo instrumenti:

- a) më vete ose i kombinuar me të tjerë, do të reflektojë pritshmëritë për efektivitetin e tij dhe shkallën e zhvillimit të sistemit financiar;
- b) në varësi të natyrës së tij, do të realizohet në përputhje me procedurat përkatëse të Bankës së Shqipërisë për konsultimin paraprak dhe miratimin e vendimeve.

IX. Mënyra dhe strukturat e vlerësimit të efektivitetit të politikës

1. Për të vlerësuar efektivitetin e kësaj politike, Banka e Shqipërisë:
 - a) do të përcaktojë treguesit që do të monitorohen dhe do të raportojë në mënyrë të rregullt rreth tyre, në mënyrë të ngjashme me parashikimet në Memorandumin e Bashkëpunimit;
 - b) do të shqyrtojë rregullisht ecurinë e treguesve të pikës (a) dhe faktorë të tjerë plotësues, dhe mbi bazën e analizës do të vlerësojë përshtatshmërinë e veprimeve të ndërmarra apo nevojën për veprime të tjera plotësuese;
2. Në Bankën e Shqipërisë, strukturat përgjegjëse për procesin e vlerësimit të efektivitetit të politikës, do të jenë:
 - a) Departamenti i Stabilitetit Financiar, për pikën 1(a);
 - b) Komiteti Këshillimor i Stabilitetit Financiar dhe/ose Komiteti Këshillimor i Politikës Monetare, për pikën 1(b);
 - c) struktura të tjera të institucionit, të cilave do t'iu kërkohet të kontribuojnë në proces.

X. Publikimi i Politikës

Kjo politikë publikohet në faqen e internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

**KRYETARI I KËSHILLIT
MBIKËQYRËS**

GENT SEJKO